



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

**Nr. 38, date 26.7.2022**

**PËR PJESMARRJEN E BASHKISË SHKODËR NË SUBJEKTE ME  
KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QËLLIM KRYERJEN E  
SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT,  
LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJRAVE TË NDOTURA**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 26.7.2022, në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9 pika 1.1, germa “b”, nenit 14 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligj nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Vendim nr. 302, datë 11.5.2022 të Këshillit të Ministrave “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura”, Vendim nr.60, datë 28.12.2020 të Këshillit Bashkiak Shkodër “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak Shkodër”, me propozim të këshilltarëve,

**V E N D O S I**

1. Miratimin në parim të pjesmarrjes së Bashkisë Shkodër në subjekte me kompetenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura, duke përfshirë si aksionar edhe ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, në përputhje me ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, për të negociuar me bashkitë e Qarkut dhe/ose bashkitë nga Qark tjetër me afërsi gjeografike, si dhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për lidhjen e marrëveshjeve specifike për krijimin e Subjekteve të Kompetencave të Përbashkëta, (SKP) për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit.

3. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Shkodër në cilësinë e tij si aksionar i vetëm i Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a., që pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta, të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve, të autorizimit për administratorin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër, për nënshkrimin e cdo akti të nevojshëm kontraktor dhe noterial me qëllim transferimin e veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SKP-UK, që do të krijohet.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**



**Brisela KADRIJA**

Sekretari i Këshillit Bashkiak

A handwritten signature in blue ink, which appears to be "DL", is written over a horizontal line.

**Denis Lesha**

Miratuar me 34 vota

Vota Pro 34

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 2

Zbardhur me datë 27.7.2022